



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira – Department Slobodnih Profesija –
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.23/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.4658/2020, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija-Kerveshi, përfaqësueset e palës ankuese-për dhe Përmbaruesi Privat, me datë 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-23/2022 i datës 19.07.2022 dhe ankesa e palës ankuese KEK e datës 18.07.2022, **si të pabazuara.**

II. Përmbaruesi Privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr. 4658/2020.

A r s y e t i m

Me datën 18.07.2022 pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat, me pretendimin se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore, pasi në lëndën P.nr.4658/2020, sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në j, PPP.nr.113/2021, dt.28.04.2021, e ka kryer përmbarimin përkundër faktit që me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në C.nr.552/2019, dt.16.04.2021, është shfuqizuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në dega

në „C.nr.552/2019, dt.01.10.2020,duke iu hequr Vula e plotëfuqishmërisë e datës 18.11.2020 dhe data e ekzekutimit 04.12.2020.

Pala ankuese ka pretenduar që përkundër njoftimit që pala debitore i ka bërë përmbaruesit përmes postës elektronike, duke e njoftuar që është shfuqizuar vendimi i gjykatës,pasi i është hequr vula e plotëfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, përmbaruesi e ka vazhduar përmbarimin,duke mos vepruar në përputhje me nenin 71,par.1.2 dhe nenin 66 të LPP-së.

Pala ankuese ka deklaruar poashtu se me këtë përmbaruesi ka bërë edhe keqpëtrdorim të pozitës zyrtare.

Në seancën dëgjimore përfaqësueset e palës ankuese deklaruan se mbesin në tërësi pranë ankesës; se si palë debitore në momentin që kanë rënë në dijeni për vendimin e gjykatës me të cilin është shfuqizuar vula e plotëfuqishmërisë dhe ekzekuteshmërisë, kanë vepruar duke e njoftuar edhe gjykatën ,ku ishte në proces vendosja sa i përket prapësimit si dhe përmbaruesin,por që nuk është ndalur përmbarimi, edhe pse përmbaruesi do duhej që zyrtarisht t'a përfundoj këtë procedurë.

I kanë propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmirren masa adekuate ndaj përmbaruesit privat.

Me datën 19.07.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat në seancën e mbajtur dëgjimore ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese, se i njëjti nuk ndihet përgjegjës në rastin konkret ,pasi përmbarimi është lejuar në bazë të titullit ekzekutiv bazuar në aktgjykimin e gjykatës , i cili ka përmbajtur vulat e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë; se debitori ka ushtruar prapësim brenda afatit ligjor dhe lënda është proceduar në gjykatë sipas prapësimit; se Gjykata themelore në _____ a vendosur lidhur me prapësimin duke e refuzuar atë; se pas pranimit të vendimit lidhur me vendosjen sipas prapësimit ka vazhduar me procedurën e ekzekutimit të mjeteve, pasi që sipas nenit ,77 , paragrafi 5 i LPP-së ,ankesa nuk e ndalon ekzekutimin.

Përmbaruesi privat poashtu ka theksuar se sa i përket pretendimeve të debitorit se lënda është dashur të përfundohet, pasi që ekziston vendimi i Gjykatës themelore në _____ ,me të cilën janë anuluar vulat e formës së prerë dhe ekzekutueshmërisë, këto pretendime nuk qëndrojnë, meqë të gjitha këto kanë qenë të përfshira në prapësim dhe gjykata i ka refuzuar ato , në tërësi.Për më tepër as pretendimi i debitorit ku është thirrë në nenin 66 të LPP-së për përfundimin e procedurës nuk qëndron, ngase dispozita është shumë e qartë ku thuhet se vërtetimi për përmbarueshmëri anulohet me vendim të formës së prerë, ndërsa në këtë rast ky vendim nuk është i formës së prerë.I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa e palës ankuese.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së,

Këtë konstatim komisioni e bazoi në shkresat e lëndës dhe deklarin e palëve.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me atë se përmbaruesi do duhej që bazuar në dispozitat e nenit 71,par.1.2 dhe nenin 66 të LPP-së,t'a përfundoj procedurën pasi kemi shfuqizim të vulës së plotëfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, komisioni konstatoi se përmbaruesi ka vepruar bazuar në vendimin e gjykatës,me të cilin është refuzuar prapësimi,gjë e cila e ka obliguar përmbaruesin të veprojt, ndërsa vendimi me të cilin është bërë shfuqizimi i vulave të plotëfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, ende nuk është i formës së prerë,ndërsa ligjvënësi me dispozitën e nenit 66 ,par. 1, ka cekur taskativisht se procedura tek këto raste përfundohet zyrtarisht, nëse vërtetimi për përmbarueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë, e që në këtë rast, ende nuk e kemi formën e prerë të këtij vendimi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.23/2022 datë 23.09.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaci



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.